




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac

VENDI TAKIMIT	I Lokaliteti I Kuvendit Komunal në Kllklot
Data	28.12.2018

Në bazë të nenit 52.pika 52.1. I 52.2. ligjit për qeverisje lokale si dhe Statutit komunal nga neni 26 .pika 26.2 është mbajtur séance e njëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit për Politikë dhe Financa në komunën e Kllklot –Vërbovcit për vitin 2018 , në lokalitetet e Kuvendit Komunal në Kllklot .me atë rast është bërë sin ë vijim :

PROCESVERBAL NGA SEANCA E NJËMBËDHJETË E RREGULLT E KOMISIONIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Seancën e udhëheqi kryesuesi I komisionit për politikë dhe fiannca z.Zarko Dejanovic .

Në fillim kryesuesi I përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë .

Pas thirrjes së antarëve konstatoi kuorumin për punën e seancës .

Antarë present 5

Në fillim të seancës kryesuesi e lexoj rendin e ditës I cili përbëhet nga 4 pika .

1. Miratimi I procesverbalit nga séance e dhjetë e rregullt e komisionit për Politikë dhe financa në vitin 2018 ;

2. Raporti për punën e Kuvendit Komunal për vitin 2018

3. Raporti I Kryetarit për situatën ekonomiko –financiare dhe planet investitive në vitin 2018 ;

4. Të ndryshme ;

Kryesuëesi Zarko Dejanovic : Mirë se erdhët në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të të Komisionit për politikë dhe financa , dëshoroj menjëher ti përshëndes të pranishmit . Të nderuar delegate keni marrë rendin e ditës së sotme të komisionit për politikë dhe financa . Bëhet fjalë për katër pika të cilat I kemi sot në rend të ditës .

Kush është për miratimin e e rendit të ditës . Konstatoi se njëzëri e kemi miratuar rendin e ditës me 5 vota për .

Kështu që kalojm në pikën e parë të rendit të ditës , ajo është : **Miratimi I procesverbalit nga séance e dhjetë e rregullt e komisionit për Politikë dhe financa në vitin 2018;**

A e dëshiron dikuash fjalën lidhur me procesverbalin .Pasi askush nuk dëshiron të thotë asgjë e jap në votim , kush është për miratimin e pikës së parë . Knstatoi se me 5 vota për e kemi mirastuar pikën e parë të rendit të ditës .

Kalojm në pikën e dytë të të rendit të ditës , ajo është ; **Raporti për punën e Kuvendit Komunal për vitin 2018;**

z.delegatë e keni marrë raportin e kuvendit shpresoj se e keni pasur parasysh dokumentacionin të cilin e keni marrë , dhe mendoj sd nuk ka nevoj të ju lexoj , a ka dikush dicka per të thënë , urdhno ;

Igor Petkovic: Mirdita të gjithve , unë ju kërkoj falje për vonesën . Unë vetëm shkurtimisht do ti them me pak fjalë , pasi që kam ndërin dhe kënaqsinë që jamë pjesë e këtij kuvendi . Ku në këtë raport shkruhet njëra nga gjetat thmeloire , të gjitha vendimet e kuvendit komunal janë miratuar . kështu që vet fjala thot se jemi një kuvend efikas për interes të gjithë qytetarëve të komunës së Kllokotit . .z.Kryesues ju falënderoj për punën dhe diciplinën në Kuvend .

Për fjalë u paraqit Atifete Rexhepi ; Nëse mundem unë , tani kam një kërkes qe të propozoj ndërsa mbas një ore të sillët , sepse po e shof se ketu ka mangësi në listë dhe nuk janë përfshirë të gjith emrat e puntorëve , neve po na inetreson që të jetë lista e të gjithë puntorëve të komunës dhe ne dëshirojm të dijm edhe për arsim , shëndetësi dhe për të gjithë personelin I cili punon në komunë edhe pë rata të cilët janë me kontratë në vepër . Të jenë të gjithë të përfshirë këtu në listë .Unë deshiroj të na dorzoni atë list.

Kryesusi Zarko Dejanovic : Ju për këtë mund të paraqiteni tek Kelmendi në zyrën dhe aji ju dorzon të gjitha . Secili document është transparent dhe mund ta marrë secili që dëshiron dhe jo vetëm ju si delegate të kuvendit . .Mund të vazhdojm me pikën e tretë të rendit të ditës ; **Raporti I Kryetarit për situatën ekonomiko –financiare dhe planet investitive në vitin 2018 ;**

Do të jetë këtu zyrtari I cili do ta prezantoj me projector , aty do të jenë present të gjithë drejtorët , nënkryetari , sepse kryetari nuk është këtui aji është në Prishtin . A dëshiron dikush të thot diqka .Pasi nuk dëshiron askush të merr fjalën kalojm në pikën **Të ndryshme** , e shof se askush nuk dëshiron të marrë fjalën , zotërinj faleminderit shumë . Kryesuesi e mbylli seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të komisionit për politikë dhe finansa

Data: 28.12.2018

Kryesuesi I Kuvendit Komunal Kllokot-Vërbovc



/Zarko Dejanovic/